



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Kuvendi**

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2014

**“PËR**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8811, DATË 17.5.2001,  
‘PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË LARTË  
TË DREJTËSISË’, I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 8811, datë 18.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Pas pikës 1, të nenit 6, shtohet pika 1/1 me përmbajtjen si vijon:

“1.1. Anëtarët e KLD-së, të zgjedhur nga KGJK-ja, nuk mund të transferohen apo të ngrihen në detyrë gjatë ushtrimit të mandatit të tyre. Edhe në rast se anëtari KLD-së, i zgjedhur nga KGJK-ja jep dorëheqjen përpara mbarimit të

afatit 5 vjeçar, ai nuk mund të transferohet apo të ngrihet në detyrë deri në përfundim të periudhës së përcaktuar në pikën 1, të këtij neni”.

## **Neni 2**

Pas shkronjës “ë”, të pikës 1, të nenit 7, shtohen shkronjat “f” dhe “g”, me përmbajtje si vijon:

“f. Anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi, shkarkohen për shkelje të Kushtetutës dhe të ligjit.

g. Anëtarët e zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, shkarkohen për shkelje të Kushtetutës dhe të ligjit.”

## **Neni 3**

Në nenin 10, bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në pikën 1, termi “propozimet”, zëvendësohet me termin “informacionet”.
2. Pika 2, e nenit 10, shfuqizohet.

## **Neni 4**

Pas pikës 5, të nenit 14, shtohen pikat 6 dhe 7, me përmbajtjen si vijon:

“6. Për Kryeinspektorin dhe inspektorët, çdo 2 vjet, kryhet vlerësimi profesional dhe etik, sipas kriterëve e procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

7. Brenda tremujorit të parë të çdo viti, Inspektorati, nëpërmjet Kryeinspektorit, i paraqet Këshillit të Lartë të Drejtësisë një raport mbi veprimtarinë e tij në vitin paraardhës, në të cilin duhet të gjejnë pasqyrim problematikat e trajtuara dhe rezultatet e punës.

Raporti i përgatitur nga Inspektorati paraqitet nga Zëvendëskryetari për diskutim në mbledhjen më të afërt të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.”

## **Neni 5**

Në nenin 21, bëhen ndryshimet si vijon:

- a) Pika 1, riformulohet si vijon:

“1. Në rastet e arrestit, heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, ushtrimit të kontrollit personal ose të banesës, së gjyqtarit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mblidhet brenda 24 orëve dhe vendos për kërkesën e paraqitur nga prokurori”.

b) Pas pikës 1, shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1.Në rastin kur është regjistruar procedimi penal ndaj një gjyqtari, Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos pezullimin e gjyqtarit nga detyra derisa të merret vendim gjyqësor i formës së prerë.

Në rastet kur fajësia nuk provohet me vendim gjyqësor të formës së prerë të gjykatës, gjyqtari ka të drejtë të kthehet në punën e tij të mëparshme dhe të marrë pagën e plotë që nga koha e pezullimit.

## **Neni 6**

Pas pikës 2, të nenit 26, shtohet pika 3, me përmbajtjen si vijon:

“3. Në qoftë se Këshilli i Lartë i Drejtësisë rrezon masën disiplinore të propozuar nga Ministri, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të vendosë një masë disiplinore më të lehtë.”

## **Neni 7**

Neni 27, ndryshohet si vijon:

“1. Në çdo mbledhje të Këshillit të Lartë të Drejtësisë mbahet një procesverbal, ku bëhet një përmbledhje e gjithçkaje u tha në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.

2. Procesverbali i mbledhjes duhet t'u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet nga zëvendëskryetari dhe anëtarët e tjerë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

3. Në rastet kur vetë organi e shikon të arsyeshme dhe mbledhja është e ndarë në seanca, procesverbali miratohet menjëherë pas përfundimit të seancës përkatëse.

4. Vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë hyjnë në fuqi vetëm pasi të jetë miratuar procesverbali përkatës.

5. Çdo anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka të drejtë të verifikojë përmbajtjen e procesverbalit dhe të paraqesë objeksionet e veta, të cilat i bëhen të ditura Këshillit të Lartë të Drejtësisë në mbledhjen pasardhëse.

6. Vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, së bashku me procesverbalet përkatëse, depozitohen pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

7. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë mund të kërkojnë që të shënohet në procesverbal fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë nga ai organ.

8. Anëtarët, të cilët kanë votuar kundër një vendimi dhe kanë kërkuar shënimin e këtij fakti në procesverbal, sipas pikës 7, të këtij neni, përjashtohen nga çdo përgjegjësi që mund të rrjedhë nga ky vendim.”

## **Neni 8**

Pas nenit 30, shtohet neni 30/1 me përmbajtje si vijon:

### **Neni 30/1**

#### **Emërimi i kryetarëve të gjykatave**

1. Vendi vakant për pozicionin e kryetarit të gjykatës, shpallet si i tillë, 3 (tre) muaj përpara përfundimit të mandatit katërvjeçar të kryetarit të gjykatës. Afati tre muaj shërben për evidentimin e kandidaturave që konkurrojnë në pozicionin e kryetarit të gjykatës dhe mbledhjen e materialeve dhe të dhënave mbi bazë të të cilave do të bëhet përzgjedhja.

2. Emërimi i kryetarit të ri nuk mund të bëhet përpara deklarimit të mbarimit të mandatit të plotë të kryetarit ekzistues dhe në çdo rast jo më vonë se një muaj nga mbarimi i mandatit të tij.

3. Në rastet kur vendi i kryetarit në një gjykatë mbetet vakant për një nga situatat e mbarimit të mandatit përpara afatit ligjor, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, delegon një nga gjyqtarët e kësaj gjykate për të kryer përkohësisht detyrën e kryetarit të gjykatës. Vendi vakant në këtë rast, duhet të plotësohet brenda tre muajve nga krijimi i tij.

4. Kryeinspektori i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, një herë në dy vjet ose kur kërkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, paraqet përpara Këshillit një raport për punën e kryer nga kryetari i gjykatës. Raporti i Kryeinspektorit bazohet edhe në:

a) raportin e të deleguarit pjesëmarrës të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në analizat vjetore të gjykatës, e veçanërisht për punën e kryetarit;

b) vizitat e Anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në gjykata gjatë mandatit të kryetarit;

c) materiale që vijnë nga Ministri i Drejtësisë;

ç) materiale të tjera që rezultojnë nga verifikimet apo kontrollet gjatë periudhës që ai ka qenë në detyrën e kryetarit të gjykatës.

5. Shqyrtimi i kandidaturave bëhet nga një komision i posaçëm i cili kryesohet nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

6. Përbërja, rregullat e funksionimit të komisionit të shqyrtimit të kandidatëve

dhe procedurat e verifikimit dhe të testimit të tyre caktohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

### **Neni 9**

Pas pikës 2, të nenit 33, shtohet pika 2.1, me përmbajtje si vijon:

“2.1. Shqyrtimi i procedimit disiplinor bëhet brenda një muaji nga data e depozitimit të dokumentacionit përkatës nga Ministri i Drejtësisë, pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.”

### **Neni 10**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**ILIR META**